

AKTIVITETI I SEKTORIT ANALITIK

Sektori analitik, i inkuadruar në Drejtorinë e Monitorimeve, pranë Departamentit Minerar, në Agjensinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, kryen me cilësi dhe garanci një sërë aktivitetesh, për nevoja të institucionit dhe të tretëve.

Sektori analitik (laboratori teknologjik dhe kimik), me një eksperiencë të madhe pune mbi 30-vjeçare, fillimisht pranë ITNP Mineraleve (Instituti i Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve) dhe sot, pranë Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, zhvillon një gamë të gjerë analizash analitike, si:

1. Përcaktime të vetive fizike të lëndëve të ngurta, të lëngëshme e të gazta

Për lëndët e ngurta

Kryen analiza të lagështisë, sitore, densimetrike, përcaktimet e peshave specifike e volumore, këndet e pjerrësisë, etj. Gjithashtu, kryen dhe sondazhe të pasurueshmërisë së lëndëve të para me gravitacion, flotacion, seperim elektromagnetik, hidrometalurgjik, etj.

Për lëndët e lëngëta (ujrat)

Kryen përcaktime të pH, konduktivitetit, tensionit, kripshmërisë, turbullisë, përmbajtjes së të ngurtave, etj.

Për lëndët e gazta

Kryen përcaktime të përmbajtjes së të ngurtave në ajër (gaze) dhe natyrës së tyre.

2. Përcaktime të vetive kimike të lëndëve të ngurta e të lëngëshme

Për të gjitha lëndët e para të ngurta ose të lëngta, si dhe produktet e tyre, sektori kryen një gamë të gjerë përcaktimesh të elementëve të ndryshëm, si:

SiO_2 , CaO , MgO , R_2O_3 , Al_2O_3 , Cu , Zn , Ni , Co , Pb , Mn , Cr , etj.

Në punën e vet ky sektor është karakterizuar nga kualifikimi i lartë, eksperiencia shumëvjeçare, si dhe pajisja e laboratorit me një sërë mjetesh moderne analitike të kohës.

Sektori analitik disponon pajisje bashkohore, si:

Absorber atomik, Fotospektrometër, Fotokolorimetër, pHmetër, konduktimetër universal, peshore elektronike tepër ekzakte dhe enë laboratorike të taruara të nivelit superior (A). Pajisjet e sipërpërmendura janë të gjitha prodhime mbas vitit 2002.

Janë të gjithë arsyet e mësipërme, që kanë bërë tepër atraktivë porositës të ndryshëm për analiza analitike në sektorin tonë dhe theksojmë se gjatë vitit 2007, punimet tona nuk kanë patur asnjë reklamim brenda apo jashtë vendit.

Ju ftojme të perfitoni nga puna korrekte, e saktë dhe e shpejtë e Sektorit Analitik pranë AKBN, Tiranë.